



Република Северна Македонија  
Министерство за одбрана

# STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT E MINISTRISË SË MBROJTJES 2025



Република Северна Македонија  
**Министерство за одбрана**

MINISTËR I MBROJTJES  
d.v. Vllado Misajlovski

# **STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT E MINISTRISË SË MBROJTJES 2025**

Nr. 3-19-858/1  
07.03.2025

Mars, 2025

## FJALA HYRËSE



Strategjia e Komunikimit e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2025 e pasqyron përkushtimin e mbrojtjes të komunikojë me qytetarët maqedonas përmes llogaridhënies, transparencës dhe duke qenë e hapur. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme sidomos në qoftë se kemi parasysh se jetojmë në një kohë të ndryshimeve të sigurisë. Kohë kur dezinformatat kanë ndikim të fuqishëm në jetën shoqërore, që përkon me një sistem të shpejtë dhe efikas të informimit që bazohet vetëm në informata të sakta dhe faktike.

Zhvillimin e mbrojtjes e pozicionojmë në tre shtylla, në buxhehtim stabil, në furnizimin me pajisje të reja dhe zhvillim të kapacitetit të fuqishëm njerëzor. Për ne në mbrojtje është e rëndësishme që të gjithë qytetarët e vendit të jenë në dijeni se si investohen paratë e tyre – në një shtet më të sigurt dhe më stabil. Po investojmë në pajisje më të sofistikuar dhe më bashkëkohore të cilën pjesëtarët e Armatës së vendit tonë e meritojnë. Investojmë në zhvillimin individual dhe kolektiv të ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve tanë, të zyrtarëve tanë, sepse pikërisht të gjithë janë shtylla e sistemit të mbrojtjes. I respektojmë të drejtat e tyre, por njëkohësisht kërkojmë edhe përkushtim të plotë dhe profesionalizëm të pashoq.

Me këtë Strategji të Komunikimit i definojmë audiencat kyçe që do të jenë në fokusin tonë sivjet, ashtu siç po i definojmë edhe temat, narativat dhe audiancat kyçe me të cilat do t'i drejtohem qytetarëve të vendit. I drejtohem opinionit vendor, por edhe opinionit të NATO-s. Atdheu ynë është aleat konfidencial që jep kontribut të drejtpërdrejtë ndaj sigurisë së të gjithë neve – 32 vendeve të bashkuara në Aleancën e vlerave.

Strategjia e Komunikimit ka të bëjë me një dokument gjithpërfshirës i cili përpos mesazheve tona, publikisht dhe në mënyrë transparente shfaq parimet përmes të cilave punon mbrojtja në domenin e marrëdhënieve me publikun, si dhe standardet profesionale për komunikatorët në Ministri. Kjo dëshmon se sistemi ynë është i vendosur në themele të shëndosha dhe se transparenca dhe të qenurit të drejtpërdrejtë e Ministrisë paraqet përkushtim të fuqishëm.

Vetëm me qytetarë të informuar që i dallojnë qëllimet e mbrojtjes, mund të zhvillojmë rezistencë të fuqishme shoqërore që do të mundësojë të gjithë të përbashkuar të ndërtojmë sistem që do të përgjigjet ndaj çdo sfide të sigurisë.

MINISTËR I MBROJTJES

**Vllado Misajlovski**

## PARIMET E KOMUNIKIMIT

Ministria e Mbrojtjes është institucioni më transparent në vend në nivel qendror dhe local për pesë vite me rradhë, katër vitet e fundit nga të cilat me maksimalisht 100% realizim të kriterëve në përputhje me Indeksin për Transparencë Aktive. Kjo dëshmon se Ministria si bartëse e sektorit të mbrojtjes, tek transparenca sheh një vlerë maksimale demokratike nga e cila nuk heq dorë. Një pjesë e rëndësishme e kësaj transparence ka të bëjë edhe me kuantumin e informative të disponueshme për funksionimin e mbrojtjes, shpenzimin e mjeteve që i dedikohen mbrojtjes, por edhe me komunikimin e vazhdueshëm dhe proaktiv me audiencat kyçe.

Sistemi i komunikimit në Ministrinë e Mbrojtjes është i vendosur në themele të shëndosha – përmes Politikës së Komunikimit Strategjik dhe përmes rregulloreve që e definojnë këtë fushë, gjë që mundëson vazhdimësi, parashikueshmëri dhe krijimin e besimit tek opinioni se Ministria e respekton interesin publik dhe se qytetarët kanë të drejtë të dinë se si shpenzohen dhe investohen paratë e tyre në një shtet më të sigurt.

Komunikimi proaktiv është i mbështetur edhe nga qasja e lehtë deri te informatat, si dhe parimet përmes së cilave punojnë komunikatorët në mbrojtje. Ministria në vazhdimësi punon në lehtësimin e mënyrës përmes së cilës qytetarët mund të arrijnë deri te informata e duhur, duke i përfshirë këtu edhe ndryshimet në ueb faqen e Ministrisë, [ëëë.mod.gov.mk](http://ëëë.mod.gov.mk) e cila paraqet bazën kyçe të informatave që kanë të bëjnë me mbrojtjen.

Përpilimi i Strategjisë së Komunikimit në esencë i sistemon temat, narativat dhe mesazhet të cilat Ministria i plason drejt audiencës dhe për të cilat pret fitbek që zbatohet përmes të gjitha mjeteve të disponueshme, duke i përfshirë këtu edhe rrejtet sociale si njërin ndër kanalet kyçe të komunikimit, përes të cilave vendoset komunikimi i dyanshëm me audiencat kyçe.

Duke e pasur parasysh mjedisin e ndryshueshëm të sigurisë, Ministria e reduktoi periudhën e përpunimit dhe përpilimit të Strategjisë së Komunikimit nga dy në vetëm një vit, ku mundësojmë modelim të përshtatshëm të temave, narativëve dhe mesazheve të realitetit në të cilin jeton secili qytetar i ynë.

Periudha e komunikimit të kësaj strategjie vjen si rezultat i Programit për Punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025, Planit Vjetor të Punës në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe nga prioritetet e udhëheqësisë së mbrojtjes.

Ministria e Mbrojtjes mbetet fuqishëm në rrugën e saj – ky është vazhdimi i të qenurit relevante, kredibile dhe institucion i hapur i cili me publikun komunikon shpejt, në mënyrë efikase dhe në kohë, me informata të sakta faktike .

## AUDIENCAT KYÇE

Definimi i audiencave kyçe është baza pikënisëse e kësaj Strategjie të Komunikimit. Mbetemi të përqëndruar ndaj hulumtimit të mjedisit të informimit dhe definimit të saktë të karakteristikave dhe interesave të audiencave kyçe, fakt ky i cili na mundëson që saktësisht t'i definojmë temat e komunikimit, narativat dhe mesazhet.

Mbrojtja përqëndrohet në dy audiencë të veçanta kyçe: vendore dhe e jashtme (NATO) audiencë.

**Audienca vendore** është në fakt audience maqedonase, e të gjitha kategorive të qytetarëve dhe moshave. Target grupe më të rëndësishme janë të punësuarit në mbrojtje, në Armatë dhe familjet e tyre, të rinjtë e moshës nga 18 - 25 vjet si tërësi e qytetarëve nga të cilët bëhet pranim në Armatë si ushtarë profesional, si dhe përfaqësues të sektorit të organizatave joqeveritare dhe bashkësisë akademike. Përfaqësuesit e mediave janë gjithashtu njëri ndër prioritetet në kuadër të procesit të komunikimit, si publik tejet i rëndësishëm në përpjekjet e komunikimit për plasimin e mesazheve të komunikimit nga opinioni i përgjithshëm.

**Audienca e jashtme** përbëhet prej audiencës së NATO – Aleancës, e segmentuar në komandat e NATO-s dhe në entitetet, udhëheqësitë e vendeve aleate, si dhe në udhëheqësitë e vendeve partnere, sidomos në kuadër të rajonit të Ballkanit.

## **I. TEMA DHE NARATIVA**

Ministria e Mbrojtjes në mënyrë aktive komunikon me publikun në temat vijuese:

### **PJESA E 1. AUDIENCA VENDORE**

TEMA 1 – QYTETARËT MAQEDONAS TË SIGURT, ATDHEU I SIGURT

TEMA 2 – FINANCIMI STABIL PËR PAJISJE MODERNE DHE BASHKËKOHORE

TEMA 3 – MBROJTJE DHE ARMATË ME KAPACITET TË FUQISHËM NJERËZOR

TEMA 4 – KAPACITETE NË SHËRBIM TË MBROJTJES KOLEKTIVE

TEMA 5 – NË SHËRBIM TË QYTETARËVE DHE TË INTERESIT PUBLIK

### **PJESA E 2. AUDIENCA E JASHTME: NATO DHE VENDET ANËTARE**

TEMA 1 – MAQEDONIA E VERIUT – ALEAT I BESUESHËM DHE I PËRKUSHTUAR


TEMA 2 – SIGURI NË MJEDISIN E NDRYSHUESHËM TË SIGURISË

TEMA 3 – KONTRIBUTI MAQEDONAS NDAJ SIGURISË KOLEKTIVE

## **PJESA E 1. AUDIENCA VENDORE**

### **TEMA 1 – QYTETARËT MAQEDONAS TË SIGURT, ATDHEU I SIGURT**

Maqedonia e Veriut është vend i sigurt. Ky është prioriteti i parë dhe më i lartë për mbrojtjen dhe për Armatën, sepse pa siguri nuk ka prosperitet dhe nuk ka zhvillim ekonomik. Me anëtarësimin në NATO filloi edhe një kapitull i ri për shtetin në të cilin sistemi i sigurisë u bë pjesë e mbrojtjes kolektive të 32 vendeve aleate që i lidhin vlerat e demokracisë, përkushtimi ndaj parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe rendit ndërkombëtar. Maqedonia e Veriut në mënyrë aktive merr pjesë në diskutimet e NATO Aleancës dhe në të gjitha vendimet që merren në emër të 32



vendeve edhe me miratimin e përfaqësuesve maqedonas. Kjo shërben si dëshmi e mjaftueshme se për ne dhe për rrjedhojat globale gjeopolitike nuk flitet me dyer të mbyllura, por se ne në mënyrë aktive jemi pjesë e diskutimeve në tavolinën ku merren vendime me implikime globale.

Në NATO jemi një për të gjithë, të gjithë për një dhe për këtë shkak mbetemi të palëkundur në mbrojtjen e çdo pëllëmbë të territorit të NATO-s, që përfshinë edhe territorin e Maqedonisë së Veriut.

Realiteti i sotëm shpie drejt ndryshimeve të fuqishme gjeopolitike në nivel global, ndërsa për vendin tonë është jashtëzakonisht e rëndësishme të mos ngelim në margjinat e këtij procesi, por nga brenda t'i mbrojmë interesat maqedonase dhe interesat e aleatëve tanë. Në këtë kontekst, bëjmë thirrje për ndërprerje të konflikteve të armatosura dhe bëjmë thirrje në mbështetje të paqes.

Garnitura e sigurisë garanton edhe një rritje të fuqizuar ekonomike. Anëtarësimi në NATO ofron mundësi të reja, treg të ri dhe progres më të shpejtë. Qëllimi ynë është që përmes politikave të mbrojtjes të sigurojmë zhvillim të qetë, pavarësi dhe sovranitet të shtetit, siguri për biznesin dhe për qytetarët. Anëtarësimi në NATO është garancë për investime të reja në shtet, por edhe mundësi për komunitetin afarist dhe për kompanitë për të marr pjesë në zinxhirin e madh të prokurimeve/furnizimeve me prodhime për nevojat e NATO Aleancës. Qendra për mbështetjen e kompanive vendore gjatë pjesëmarrjes në tenderët e NATO-s, e lehtëson qasjen në tregun e NATO-s dhe i shpia kompanitë vendore drejt këtij procesi.

**Mesazhe kyçe:**

1. Maqedonia e Veriut është vend i sigurt, anëtare e aleancës më të fuqishme ushtarako-politike në histori. Ne jemi në një tryezë së bashku me më të fuqishmit, tryezë në të cilën marrim vendime për një botë më të sigurt. Anëtarësimi në NATO është edhe një garancë për sovranitetin dhe integritetin territorial të atdheut tonë.
2. Ndryshimet e sigurisë kërkojnë syçelësi dhe zhdërvjelltësi të vazhdueshme. I mbështesim vendimet që kanë të bëjnë me paqen dhe sigrinë, për më tepër kanë të bëjmë me një NATO dhe me një shtet të sigurt. Bëjm thirrje për logjikë të shëndoshë, ndërprerjen e veprimeve luftarake dhe për paqe afatgjate.
3. Siguria e garantuar është garancë për zhvillim më të shpejt ekonomik dhe për investime. Anëtarësimi në NATO do të thotë stabilitet dhe investime të reja në shtet. Jemi tërësisht të përkushtuar në mbështetjen e komunitetit tonë të biznesit në pjesëmarrjen në tregun e NATO-s. Sa më tepër tenderë të NATO-s, aq më shumë zhvillim ekonomik.

**TEMA 2 – FINANCIMI STABIL PËR PAJISJE MODERNE DHE BASHKËKOHORE**

Buxheti i mbrojtjes shkon gjithnjë e më shumë drejt rritjes. Buxheti i mbrojtjes maqedonase është në kuadër të nivelit të përbashkët të riafirmuar – 2 për qind nga bruto prodhimi vendor të shtetit. Në vitin 2025, buxheti i mbrojtjes është në nivel prej 2 për qind nga BPV e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht 329 milion euro, që është për 5 milion euro më tepër për dallim nga viti i kaluar. Gjithashtu, është e rëndësishme se investimet në Armatë, jo vetëm që nuk reduktohen, por të njejtat intenzifikohen. Sivjet, mbi 32 për qind nga buxheti i mbrojtjes janë të alokuara për pajisje të re dhe bashkëkohore për Armatën. Këto mjete përfshijnë mbi 106 milion euro, apo 18 milion euro më tepër se në vitin 2024 – për pajisje të re, bashkëkohore dhe të sofistikuar, në përputhje me standardet më të larta të NATO-s.



Viti 2025 është vit i vendosjes intenzive të pajisjeve të reja bashkëkohore në kuadër të Armatës. Vazhdojmë me furnizimin me automjetet e reja të blinduara të lehta të llojit JLTV, 38 nga të cilat tashmë janë pjesë e arsenalit ushtarak. Sivjet do të fillojë edhe arritja e automjeteve të blinduara të llojit Stryker. Nga sistemet e pajisjeve kundërajrore dhe artilerike, sivjet si pjesë e kapaciteteve ushtarake do të arrijnë edhe sistemet artilerike "Boran" nga Turqia aleate, si dhe sistemi i mbrojtjes kundërajrore në lartësi të ulëta "Mistral 3" nga Franca. Në vitin 2025 vijojnë edhe furnizimet për pajisje të nevojshme personale përcjellëse, sepse modernizimi dhe pajisshmëria e Armatës është një proces gjithpërfshirës.

Vazhdon dhe furnizimi i fluturakeve që janë pjesë e komponentës ajrore të Armatës. Kontrata me shtetin italian dhe me kompaninë „Leonardo“ është aktive dhe është kontrata më e madhe që e posedon Ministria e Mbrojtjes. Për ne është e rëndësishme që kjo kontratë dhe ky prokurim të realizohen në përputhje me të gjitha procedurat dhe rregullativat juridike. Furnizimi me tetë helikopterët e ri do të realizohet dhe 2 helikopterët e parë, pritet të arrijnë gjatë vitit të ardhshëm 2026.

Financimi stabil i Armatës mundëson rritjen e gjendjes së gatishmërisë dhe ndërveprimit të Armatës, si dhe përmirësimin e kushteve të punës. Vështirësia e modernizimit bie te njësitë e deklaruar, më saktësisht te Grupi i Lehtë Këmbësorik Luftarak, ndërsa procesi i modernizimit dhe pajisshmërisë është në përputhje me shkathtësitë e mbrojtjes për vitet 2023-2032, si dhe me NATO - caqet e shkathtësisë.

### **Mesazhe kyçe:**

1. Jemi tërësisht të përkushtuar ndaj financimit stabil në mbrojtje, duke përfshirë edhe procesin e modernizimit dhe pajisshmërisë që po intenzifikohet. Nga viti në vit ka gjithnjë e më shumë para për një NATO Armatë më të motivuar, më bashkëkohore dhe më të fuqishme ! Buxheti i mbrojtjes arrinë 329 milion euro, nga të cilat mbi 32 për qind apo 106 milion euro janë të dedikuara për modernizim dhe pajisshmëri. Kjo është garancë se modernizimi do të vazhdojë të realizohet në mënyrë intenzive.
2. Furnizohemi me pajisje të re dhe bashkëkohore për shtet më të fuqishëm dhe për NATO më të sigurt. Për një NATO – Armatë, nevojiten NATO – kushte. Në vitin 2025, vazhdojmë me procesin e furnizimit me automjete të blinduara të llojit JLTV, arrijnë edhe automjetet e blinduara të llojit Stryker, arrijnë edhe sistemet artilerike “Boran”, si dhe sistemi i mbrojtjes kundërajrore në lartësi të ulëta “Mistral 3”.
3. Fokusi ynë është Grupi i Lehtë i Batalionit Këmbësorik, NATO njësia jonë e deklaruar, por njëkohësisht investojmë edhe në çdo segment të Armatës! Modernizimi realizohet në përputhje me dokumentet strategjike dhe ky është një proces i cili udhëhiqet nga profesionistë të dëshmuar në mbrojtje dhe në Armatë. Për ne udhërrëfyes kryesor është Plani Afatgjatë për Zhvillimin e Shkathtësive të Mbrojtjes 2023 – 2032 si dhe NATO – caqet e shkathtësisë.

## **TEMA 3 – MBROJTJE DHE ARMATË ME KAPACITET TË FUQISHËM NJERËZOR**

Kapacitet i fuqishëm dhe i zhvilluar njerëzor është njëri ndër tre shtyllat mbi të cilat e bazojmë mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ministria do të vazhdojë të investojë te të punësuarit e tyre dhe te të gjithë pjesëtarët e Armatës, në zhvillimin e tyre profesional, por edhe në respektimin e plotë të të gjithë obligimeve që dalin nga Ligji për të Punësuarit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe nga Ligji për Shërbim në Armatë, si dhe nga Marrëveshja Kolektive. Investimi në mbrojtje nënkupton edhe investim te të punësuarit tanë dhe për këtë shkak rrjedhimisht respektohen të gjitha obligimet ndaj tyre, në të njëjtën mënyrë ashtu si ata që me profesionalizmin e tyre, janë tërësisht të angazhuar në ruajtjen e sigurisë së vendit. Sivjet, një



e treat e buxhetit i dedikohet të punësuarve, me anë të të cilit do të mbulohen të gjitha kërkesat financiare në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

Kujdesi për të punësuarit nënkupton edhe zhvillim stabil në karrierë, riedukim i vazhdueshëm nëpër qendrat e arsimit në vend dhe jashtë vendit, si dhe pjesëmarrje në stërvitje dhe trajnime së bashku me armatat aleate.

Njëkohësisht, kujdesemi edhe për përmbushjen e përshtatshme të Armatës – me ushtarë të rinj profesional, me qytetarë të ri dhe të motivuar maqedonas të cilët dëshirojnë t'i shërbejnë atdheut. Në vitin 2025, Armata do të ripërtrihet me 300 ushtarë të rinj profesional. Sivjet është planifikuar edhe pranimi i qytetarëve me fakultete civile, të cilët pas kursit 6 mujor do të shëndrrohen në oficerë. Gjithsesi, është planifikuar edhe pranimi i 26 kadetëve, të cilët sivjet i përfundojnë studimet e tyre pranë Akademisë Ushtarake. Planifikojmë të prodhojmë edhe nënoficerë të rinj. Po i përmbushim kuadrot që për Armatën kanë të bëjnë me specialitetet kritike. Gjatë vitit 2025 do të realizojmë pranimin e bursistit të parë në përputhje me Ligjin për Shërbim në Armatë. Në këtë mënyrë dëshmojmë se sistemi funksionon, por njëkohësisht kujdesemi që edhe të rinjtë të mbeten në vendin tonë. Vazhdojmë t'u ofrojmë bursa kuadrore me njohuri specifike të cilët i nevojiten Armatës dhe të cilët pas përfundimit të shkollimit të tyre, njohuritë e fituara do t'i përdorin në rradhët e Armatës. Pranimë do të ketë edhe në rradhët e nënpunësve në mbrojtje dhe personave civil në shërbim të Armatës, duke i pasur parasysh nevojat tona dhe fluksin e kuadrit në baza të ndryshme, kryesisht penzionimit. Sistemi i mbrojtjes duhet patjetër të funksionojë dhe për këtë shkak nuk do të lejojmë që mbrojtja dhe Armata të ballafaqohen me mungesë të profesionistëve.

### **Mesazhe kyçe :**

1. Kapacitetet njerëzore në mbrojtje dhe Armatë janë prioriteti ynë parësor. Armata duhet të disponojë me kuadër të motivuar dhe profesional detyra parësore e të cilit është – siguria e atdheut dhe siguria e qytetarëve.
2. Ministria investon te të punësuarit. Në tërësi i respektojmë obligimet ndaj të punësuarve të të dala nga zgjidhjet ligjore dhe nga Marrëveshja Kolektive. Mbetemi të përqëndruar në zhvillimin e tyre profesional, në trajnimet dhe stërvitjet e vazhdueshme, në vend dhe në vendet aleate.
3. Kujdesemi për përmbushjen dhe për ripërtrirjen e Armatës. Pranimi i planifikuar i ushtarëve profesional, nënoficerëve, oficerëve do të ruajë nivelin e duhur të përmbushmërisë në Armatë dhe do të mundësojë që sistemi të vazhdojë të funksionojë në mënyrën më të mirë të mundshme.

## **TEMA 4 – KAPACITETE NË SHËRBIM TË MBROJTJES KOLEKTIVE**

Me anëtarimin në NATO, vendi ynë dhe Armata kaluan nga sistemi kombëtar kolektiv i mbrojtjes, në të cilin janë të theksuara ndërveprimi dhe zhvillimi i një seti specifik të kapaciteteve të cilat e rumbullaksojnë mbrojtjen kolektive në të gjithë NATO territorin, duke përfshirë këtu edhe 32 vende anëtare. Armata maqedonase jep jo vetëm kontribut deklarativ, por edhe real, ndaj njërit ndër potulatet më të rëndësishëm të Aleancës – mbrojtjes dhe përgjigjes, edhe atë në kuadër të forcave shumëkombëshe të NATO-s në Letoni, Bullgari dhe Rumani. Kontributi vazhdon, dhe gjatë vitit 2025, përmes rotacioneve të planifikuara për të cilat është paraparë edhe mbështetje buxhetore.



Maqedonia e Veriut mbetet në përkushtimin e saj për ruajtjen dhe për fuqizimin e sigurisë edhe në nivel rajonal – edhe atë përmes pjesëmarrjes në misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR, në operacionin e Bashkimit Europian në Bosnje e Hercegovinë, EUFOR-ALTEA, ndërsa me pjesëtarë të saj, ne e vazhdojmë edhe pjesëmarrjen në misionin e Kombeve të Bashkuara në Liban, UNIFIL, si një rajon që është në afërsi gjeografike me rajonin e Ballkanit.

Në vendin tonë funksionon edhe një ndër poligonët më të mëdhenj për trajnim në rajon, poligoni ushtarak “Krivollak”, ku në vazhdimësi zhvillohen stërvitje të mëdha dhe komplekse shumëkombëshe. Poligoni “Krivollak” shumë herë deri më tani e ka dëshmuar vlerën e tij, si



vend në të cilin mund në mënyrë simultane të zhvillohen disa aktivitete të ndryshme të renduara nën një stërvitje të njëjtë. Ministria e Mbrojtjes dhe zhvillimi i përmbajtjeve të infrastrukturës në këtë poligon, i vendos si një ndër prioritet e saj parësore.

Sa i përket kapacitetit me të cilin vendi kontribuon në kuadër të NATO-s, për t'u përmendur është edhe zhvillimi i Qendrës Rajonale për Marrëdhënie me Publikun, i cili është i pozicionuar në qendër të kërkesave të Aleancës, për oficerë të rinj të motivuar

dhe të trajnuar për marrëdhënie me publikun. Kjo fushë është edhe më e rëndësishme duke pasur parasysh mjedisin momental informativ i cili karakterizohet me një numër të madh dezinformatash dhe me nevojë të pashmangshme për shpërndarjen e informatave të sakta dhe faktike. Pas realizimit të suksesshëm të ekipit vlerësues të NATO Aleancës, ky kapacitet maqedonas fitoi NATO akreditimin e pakushtëzuar, që është edhe një dëshmi se Qendra funksionon në përputhje me standardet më të larta të Aleancës dhe se ka vendosur system të kontrollit dhe cilësisë i cili tregon se trajnimet të cilat realizohen, kanë një nivel të lartë të cilësisë në vazhdimësi, ashti siç është paraqitur edhe në NATO dokumentet përkatëse.

### **Mesazhe kyçe:**

1. Vendi ynë është aleat aktiv dhe i përkushtuar i cili jep kontribut real në fuqizimin e mbrojtjes dhe rezistencës së NATO-s. Ushtarët maqedonas janë pjesë e forcave shumëkombëshe të Aleancës në Letoni, Bullgari dhe Rumani dhe ne aty do të mbetemi edhe gjatë vitit 2025, duke punuar së bashku me armatat aleate në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në krahun lindor të NATO-s.
2. Poligoni “Krivollak” është kapaciteti ynë më i madh stërvitor i cili mundëson stërvitje gjithpërfshirëse dhe zhvillim të ndërveprimit me armatat aleate. Ministria e Mbrojtjes vazhdon t'i zhvillojë përmbajtjet dhe infrastrukturën e këtij poligoni i cili është një ndër prioritetet për Armatën dhe mbrojtjen.
3. Kontribuojmë edhe në kuadër të kapaciteteve jokinetike të Aleancës. Qendra Rajonale për Marrëdhënie me Publikun përfitoi NATO akreditimin e pakushtëzuar, që do të thotë se trajnimet dhe stërvitjet që organizohen në këtë qendër unike janë në përputhje me standardet më të larta të Aleancës.

## TEMA 5 – NË SHËRBIM TË QYTETARËVE DHE TË INTERESIT PUBLIK

Ministria e Mbrojtjes vazhdon të jetë në krye të institucioneve, me transparencë më të lartë aktive krahasuar me të gjitha institucionet tjera në nivel lokal dhe qendror. Për ne, transparenca paraqet kodin tonë dhe nga kjo ne nuk heqim dorë. Në vitin 2024 mbetëm në krye me përmbushje 100 përqind të kriterëve në përputhje me matjet e pavarura, dhe në këtë mënyrë vazhdojmë edhe në vitin 2025. Parimi ynë është i qartë – mbrojtja të jetë maksimalisht e hapur kundrejt qytetarëve.

Viti	Q. Nr.	Institucija	Rezultati 2024	Rezultati 2023
1	1	Министерство за одбрана	100,0 %	100,0 %
2	4	Министерство за труд и социјална политика	97,8 %	95,7 %
3	10	Министерство за внатрешни работи	95,7 %	87,5 %
3	4	Министерство за земјоделство, шумарство и водостопанство	95,7 %	95,7 %
5	6	Министерство за здравство	93,5 %	91,3 %
5	7	Министерство за локална самоуправа	93,5 %	90,9 %
7	8	Министерство за животна средина и просторно планирање	91,7 %	89,1 %
7	8	Министерство за информатичко општество и администрација	91,7 %	89,1 %
9	3	Министерство за финансии	90,7 %	98,1 %
10	1	Влада на РСМ	87,0 %	100,0 %
11	11	Министерство за економија	82,6 %	87,0 %
12	16	Министерство за надворешни работи	78,3 %	67,4 %
13	12	Министерство за образование и наука	76,1 %	82,6 %
14	13	Министерство за транспорт и врски	75,0 %	80,4 %
15	15	Министерство за култура	73,9 %	71,1 %
15	14	Министерство за правда	73,9 %	79,2 %
17	17	Министерство за правни работи	60,9 %	52,2 %

Njëkohësisht, përmes monitorimit gjithpërfshirës medial dhe akvitetëve në fushën e shtyllës parandaluese të sistemit për ballafaqim me dezinformata, mbrojtja në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme lfton me këtë fenomen të dëmshëm. Vazhdojmë me kredibilitet, me informata të sakta dhe në kohë reale, si dhe me zhvillimin e kapaciteteve të komunikimit strategjik të punojmë që mbrojtja të vazhdojë të jetë transparente, llogaridhënëse dhe si institucion, e hapur.

### Mesazhe kyçe:

1. Ministria edhe gjatë vitit 2024 është institucion me 100 përqind përmbushje të kriterëve të matjeve të pavarura të transparencës aktive. Ishim dhe mbetemi institucion që të parët arritëm 100 përqind dhe do të mbetemi që në mënyrë të përkushtuar të punojmë dhe në këtë drejtim.
2. Vazhdojmë t'a zhvillojmë sistemin e komunikimit në Ministri i cili garanton transparencë, derisa njëkohësisht ndërtojmë mirëbesim me audiencat tona kyçe. Do t'a vazhdojmë bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe me sektorin akademik në mënyrë që të mundësojmë zhvillim të papenguar të rezistencës shoqërore ndaj të gjitha ndikimeve negative në mjedisin informativ.
3. Kushtojmë rëndësi edhe ndaj sistemit për ballafaqim me dezinformata me të cilat luftojmë në mënyrë kredibile, dhe me informata të sakta. Ministria pozicionohet si burimi i vetëm i informative të sakta dhe në kohë në fushën e mbrojtjes.

## PJESA 2. NATO AUDIENCA

### TEMA 1 – MAQEDONIA E VERIUT – ALEAT KREDIBIL DHE I BESUESHËM

Me vendin tonë në Aleancë, NATO është më i sigurt dhe më stabil. Qytetarët tanë i jetojnë vlerat e njejta si të gjithë qytetarët tjerë të vendeve anëtare. Maqedonia e Veriut është vend funksional demokratik ku janë të themeluara vlerat perëndimore – barazia sipas të gjitha elementeve, sundimi i së drejtës dhe liria e shprehjes.

БУЏЕТ НА МИНИСТЕРСТВОТО ЗА ОДБРАНА  
ЗА 20205 ГОДИНА

2% од БДП, 32% за опремување и модернизација

Misioni ynë është mision i Aleancës – siguria e secilës pëllëmbë të tokës aleate dhe e mbi 1 miliardë njerëzve të botës. I respektojmë plotësisht vendimet e marra bashkarisht në kuadër të NATO-s. Ndajmë 2 për qind të bruto prodhimit vendor për buxhetin e mbrojtjes, 32 për qind nga të cilat për modernizim dhe për pajishshmëri të Armatës. Me investimet në mbrojtje, investojmë në mbrojtje më të fuqishme kolektive të NATO-s.

Ne INVESTOJMË në mbrojtje, MODERNIZOJMË pajjet dhe armatimin dhe jemi PJESËMARRËS në misione paqësore, operacionë dhe në aktivitete tjera të Aleancës.

## TEMA 2 – SIGURI NË MJEDISIN E NDRYSHUESHËM TË SIGURISË

Veçojmë dhe po e njohim realitetin e ri, barrën e cënimit e sigurisë në kontinentin evropian. Bëjmë thirrje për vendosjen e paqes dhe për siguri të përhershme.

NATO ka një qëllim parësor – mbrojtjen e territorit të vet. Aleanca nuk paraqet kërcënim për askend. Maturia dhe pragmatizmi ynë nuk duhet të shkaktojë dyshim se së bashku jemi të gatshëm të mbrojmë territorin dhe vlerat tona.



## TEMA 3 – KONTRIBUTI MAQEDONAS DREJT SIGURISË KOLEKTIVE

Pjesëtarët e Armatës maqedonase më tepër se dy dekada japin kontributin e tyre në vendosjen e paqes dhe sigurisë në nivel global. Me pjesëmarrjen në misionin ISAF dhe “Përkrahje e Vendosur” në Afganistan, dëshmuam se mundemi që së bashku t’a sjellim paqen. Sot, punojmë së bashku me aleatët në ruajtjen e sigurisë në krahun lindor të NATO-s, por njëkohësisht me ushtarët tanë vëjmë vullë edhe në sigurinë rajonale.

Maqedonia e Veriut në mënyrë aktive merr pjesë në kuadër të forcave multilaterale të Aleancës në Letoni, Rumani dhe Bullgari dhe krah për krah me vendet tjera paraqet garancë për sigurinë e krahut lindor të Aleancës. Në vitin 2025 vazhdon pjesëmarrja në misionin e NATO-s në Republikën e Kosovës, KFOR njëlloj si që vazhdojmë edhe më pjesëmarrjen në misionin e BE-së në Bosnje e Hercegovinë, EUFOR-ALTEA.



NATO akreditimi i pakushtëzuar për Qendrën Rajonale për Marrëdhënie me Publikun do të thotë mbështetje serioze në zhvillimin e komunikimit strategjik dhe në marrëdhëniet ushtarake me publikun në nivel të të gjithë

Aleancës. Vazhdojmë të punojmë me qëllim që të trajnojmë sa më shumë komunikatorë të NATO-s të cilët do të na ndihmojnë në luftën tonë për të vërtetën!

## II. BALLAFAQIM ME DEZINFORMATA

Dezinformatat njihen si njërat ndër sfidat kryesore ndaj sigurisë në çdo shoqëri bashkëkohore. Kjo është veçanërisht e evidente në realitetin e sotëm të sigurisë. Konflikti në tokën europiane dëshmoi se paralelisht me luftimet tokësore, detare dhe ajrore, zhvillohet luftë për të vërtetën edhe në sferën e informacionit. Ministria e Mbrojtjes punon në mënyrë aktive në zhvillimin e shkathtësive për ballafaqim me dezinformata, në suaza të së cilave zhvillohet një i a.q rol parandalues dhe arsimor, së bashku me funksionin e zbulimit të shpejt dhe me kohe të dezinformatave dhe të krijimit të një sistemi për përgjigje të shpejt të detektimit të dezinformatave. Bartës i këtij sistemi është Sektori për Kounikim dhe Informim (me një fukcion proaktiv dhe reaktiv), si dhe Sektori – Qendra Rajonale për Marrëdhënie me Publikun (me funksion parandalues).

Sipas konceptit për zhvillimin e një sistemi për trajtimin e dezinformatave, **funksioni parandalues** përqendrohet në zhvillimin e shkrim-leximit mediatik përmes organizimit dhe realizimit të trajnimeve dhe kurseve, si dhe përmes bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, komunitetin akademik dhe sektorin joqeveritar. Parandalimi përfshin gjithashtu realizimin e seminareve dhe seminareve me përfaqësues të mediave për të rritur kuptimin e fushës së mbrojtjes, si dhe bashkëpunimin me fakultetet e gazetarisë dhe marrëdhënieve me publikun.

**Funksioni proaktiv** i referohet prodhimit të vazhdueshëm të materialit informativ që do të mundësojë trajtimin efikas të dezinformatave, planifikimin në kohë për shfaqjen e mundshme të dezinformatave, organizimin e të ashtuquajturve. "ngjarjet e komunitetit" me synimin për të afruar aktivitetet e mbrojtjes me qytetarët, si dhe rrjetëzimin me kapacitetet kombëtare, të NATO-s dhe BE-së për trajtimin e dezinformatave (e a.q. „fact-checkers“).

**Funksioni Reaktiv** para së gjithash do të thotë monitorim gjithëpërfshirës i mediave dhe krijimi i një sistemi për rrjedhje të shpejtë të informacionit për ekzistimin e dezinformatave të caktuara (sistemi i raportimit të shpejtë brenda Ministrisë dhe Armatës). Në Ministrinë e Mbrojtjes ekziston një sistem informacioni i shpejtë në lidhje me lajmet e zbuluara dhe zbatimin e tij tek menaxhmenti. Duke përdorur mjetet e komunikimit dixhital, çdo lajm me konotacion negativ dhe potencial për t'u përkufizuar si dezinformim kontrollohet në mënyrë efektive, si pikënisje për aktivitetet e mëvonshme në fushën e marrëdhënieve me publikun.

Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë dhe Armatës në fushën e komunikimeve strategjike është një nga prioritetet kryesore, veçanërisht në fushën e zhvillimit të personave për realizimin e tyre. Qendra Rajonale e Marrëdhënieve me Publikun, në përputhje me planet vjetore të trajnimit, zhvillon vazhdimisht kurse për marrëdhënie me publikun. Kjo qendër fokusohet edhe në zhvillimin e kapaciteteve dhe potencialit njerëzor me njohuri në fushën e trajtimit të dezinformimit, për të cilin është zhvilluar një kurs për trajtimin e dezinformimit dhe ndërtimin e elasticitetit.

### III. SISTEMI I KOMUNIKIMIT NË MINISTRINË E MBROJTJES

Ministria operon sipas parimit të "hapjes maksimale me vonesë minimale", duke u vendosur në vazhdimësi si burimi më i shpejtë i informacionit plotësisht të saktë dhe të verifikuar, **pra si burimi i parë dhe më i besueshëm i informacionit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë** në vendin tonë. Kjo nënkupton krijimin e vazhdueshëm të një brendi të njohur në të cilin qytetarët kanë besim të padiskutueshëm.

Një nga bazat e komunikimit efektiv është zhvillimi i një procesi gjithëpërfshirës të komunikimit strategjik në Ministri dhe Armatë, që nënkupton koordinim dhe zbatim efikas dhe efektiv të aktiviteteve dhe aftësive të komunikimit të saj, si mbështetje për politikën, operacionet dhe aktivitetet e tjera, për përmbushjen e synimeve të shtetit, Ministrisë dhe Armatës.

Komunikimi strategjik shihet si një proces i adaptueshëm që lejon të kuptojë plotësisht audiencën e synuar, të kryejë koordinimin dhe sinkronizimin e vazhdueshëm të tregimeve, temave dhe mesazheve, si dhe të përcaktojë rezultatin konkret të veprimeve të ndërmarra. Përfitimi kryesor nga ngritja e një sistemi efikas të komunikimeve strategjike është mundësia e vendosjes së koordinuar, parandaluese, proaktive dhe reaktive të informacionit përmes të gjitha kanaleve dhe me të gjitha mjetet e duhura të marrëdhënieve me publikun në një moment kyç për realizimin e vizionit dhe misionit të Ministrisë dhe Armatës.

Informimi i qytetarëve bazohet në saktësi, qartësi dhe kohë, duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi, më të përshtatshmet për audiencat kryesore të përcaktuara, brenda dhe jashtë vendit. Interesi publik është angazhimi ynë kryesor.

Sistemi i komunikimit në Ministrinë e Mbrojtjes përbëhet nga Sektori për Informim dhe Komunikim (SIK), si bërthama përgjegjëse për kryerjen e komunikimeve - të brendshme dhe të jashtme. Sektori, i vendosur funksionalisht në Drejtorinë e Komunikimit, përbëhet nga Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i Analizës së Medias dhe Sektori i Botimtarisë. Për shkak të funksionit të tij, ky sektor është i lidhur pazgjidhshmërisht me Sektorin - Qendrën Rajonale për Marrëdhënie me Publikun (S-QRMP), e cila është pjesë e Drejtorisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Edukim dhe Trajnim.

Funksionet në këtë departament përfshijnë zhvillimin e sistemit të informacionit, organizimin e plotë të aktiviteteve mediatike, prodhimin e materialit të shkruar në promovimin e aktiviteteve të Ministrisë, përgatitja e analizave mediatike dhe rishikimi ditor, organizimi dhe zbatimi i veprimtarisë botuese dhe në bashkëpunim me S-QRMP dhe realizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të marrëdhënieve me publikun në shtet dhe në Aleancë.

## **Cilat janë parimet e komunikimeve strategjike nga të cilat udhëhiqemi ?**

Komunikimet strategjike duhet të kuptohen si një proces dhe një mënyrë të menduari që lejon një kuptim më të gjerë të karakteristikave të mjedisit të informacionit në të cilin narrativat kryesore përkthehen në tema specifike nga të cilat lindin fushatat dhe aktivitetet.

Të gjithë këto elemente bazohen në parimet e mëposhtme:

- Të gjitha aktivitetet bazohen në vlerat demokratike;
- Kredibiliteti dhe besimi janë thelbësore dhe si të tilla duhet të kenë prioritet gjatë kryerjes së komunikimeve;
- Aktivitetet kryhen në përputhje me objektivat e Ministrisë dhe Armatës të përcaktuara në dokumentet strategjike, politikat dhe narrativat;
- Fjalët duhet të pasqyrojnë veprime; veprimet duhet të pasqyrojnë fjalët;
- Komunikimet strategjike është një proces i përbashkët, i koordinuar dhe i integruar i Ministrisë dhe Armatës;
- Të kuptuarit e mjedisit të informacionit në të cilin tregtohen produktet e marrëdhënieve me publikun, duke përdorur mjete të përshtatshme, përmes kanaleve të përshtatshme, është thelbësor për arritjen e efektit të dëshiruar. Ai gjithashtu nënkupton mirëkuptimin, vlerat dhe mendësitë e audiencës së targetuar;
- Të kuptuarit se çdo person që është pjesë përbërëse e Ministrisë dhe Armatës është përfaqësues i institucionit dhe në këtë kontekst përcjell mesazhet e institucionit sipas parimit të “një zëri”;
- Të kuptuarit e çdo punonjësi në Ministri dhe në Armatë se i përkasin një ekipi të përbashkët që ka të njëjtin qëllim, të njëjtin mision dhe të njëjtin vizion;
- Fokusi i të gjitha aktiviteteve të komunikimit strategjik është në arritjen e efektit dhe rezultatit të dëshiruar.

Ne kujdesemi për profesionalizimin e komunikimeve të mbrojtjes. Ne investojmë te profesionistët që punojnë në këtë fushë sepse aftësitë e tyre nënkuptojnë edhe një sistem informacioni më efikas. Këta nënpunës në Ministri janë edhe komunikatorë të qeverisë dhe në këtë kontekst ndjekin Kodin e Sjelljes së Zyrtarëve të Qeverisë për Marrëdhënie me Publikun sipas të cilit detyra e tyre themelore është publikut t'i përcjellë pikëpamjet dhe politikat zyrtare të Ministrisë dhe me etikën, motivimin, aftësitë dhe aftësitë e tyre të kontribuojnë në parimet bazë të funksionimit të pushtetit ekzekutiv - transparencën, çiltërsinë dhe llogaridhënie.

Nënpunësit për marrëdhënie me publikun në Ministrinë e Mbrojtjes:

- ✓ gjithmonë e thonë të vërtetën;
- ✓ ata janë të paanshëm;
- ✓ janë të kujdesshëm me qasjen e tyre;
- ✓ ruajnë objektivitetin;
- ✓ marrin vendime vetëm në bazë të analizës paraprake;
- ✓ obligimet që dalin nga shërbimi i vendosin para interesave personale;
- ✓ tek ata ekziston ndërgjegjësim jashtëzakonisht i zhvilluar për mundësinë e një konflikti interesash;
- ✓ ata qartë ndajnë veprimtarinë e tyre private nga veprimtaria e tyre profesionale.

Ministria njih vlerën e kanaleve të reja të komunikimit, rrjeteve sociale që mundësojnë komunikim të drejtpërdrejtë dhe të dyanshëm me qytetarët, që është arsyeja e interesimit tonë për të qenë pjesëmarrës aktiv në këtë sferë. Qëllimi ynë është të tërheqim vëmendjen e qytetarëve përmes rrjeteve sociale, por edhe t'i ndihmojmë në mënyrë aktive dhe të menjëhershme të kuptojnë sistemin e mbrojtjes, funksionet dhe detyrat e tij.

Komunikatorët në Ministrinë e Mbrojtjes janë gjithashtu të kujdesshëm për mënyrën se si i përdorin rrjetet sociale me kanalet e tyre private. Sjellja e këtyre komunikatorëve në kanalet private lidhet drejtpërdrejt me personalitetin dhe besueshmërinë e tyre, e cila transferohet në mjedisin e punës. Lidhja e padiskutueshme e sjelljes së profileve personale me një pozicion si oficer i marrëdhënieve me publikun në Ministrinë e Mbrojtjes ka potencial të dëmtojë besueshmërinë e institucionit dhe për këtë arsye komunikimet e papërshtatshme që përmbajnë përmbajtje diskriminuese, fyese, kërcënuese ose elemente të gjuhës së urrejtjes duhet të shmangen tërësisht. Kredibiliteti apo besueshmëria e institucionit, i cili në komunikim bazohet kryesisht në saktësinë faktike, nuk duhet të vihet në dyshim.

**MINISTRIA E MBROJTJES**  
DREJTORIA PËR KOMUNIKIM  
Sektori për Informim dhe Komunikim  
Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun

Na ndiqni:



@DefenceMKD



@DefenceMKD



Министерство за одбрана

